

Roli i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit


Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit është struktura teknike, në nivel qendror, përgjegjëse për hartimin, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave kundër korrupsionit në Shqipëri.

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit harton dhe ndjek kuadrin strategjik kundër korrupsionit, përgatitjen e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, hartimin dhe zbatimin e mekanizmave të integritetit, politikave dhe aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe të edukimit kundër korrupsionit. Është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimin e punonjësve të institucioneve publike që kryejnë abuzime me detyrën. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit koordinon mekanizmin e referimit, të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Buletini elektronik është një mjet komunikimi që synon të informojë aktivitetet kryesore, iniciativat dhe zhvillimet në fushën e luftës kundër korrupsionit, duke ofruar një përmbledhje mujore të punës së institucionit.

Aktivitetet përgjatë muajit prill, 2026**Ekipi Tematik Antikorrupsion miraton raportin e monitorimit 2025 të strategjisë antikorrupsion**

16.04.2026: Ekipi Tematik Antikorrupsion u mbledh nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, njëherazi Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit, Adea Pirdeni, e miratoi Raportin e Monitorimit vjetor 2025, mbi zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe të Planit të Veprimit. Raporti paraqet një pasqyrë të detajuar të progresit të arritur për zbatimin e masave të parashikuara, sfidat dhe problematikat gjatë vitit të zbatimit, 2025. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për vitin 2025 ka shënuar një nivel realizimi prej 83.5%. Nga 47 masa dhe 138 aktivitete të planifikuara, rezultojnë të zbatuara 24 masa dhe 91 aktivitete, 16 masa dhe 20 aktivitete kanë mbetur në proces zbatimi, dhe 7 masa dhe 27 aktivitete nuk janë realizuar. Vlerat e synuara janë arritur për 16 tregues performance gjithsej, nga 24. Sa i takon rezultateve, në vitin 2025, janë miratuar 3 prej nismave ligjore të paketës “Antikorrupsioni”, shtuar kapacitetet njerëzore e teknike institucionale në autoritetet publike për nismat antikorrupsion, hartuar dhe miratuar metodologjitë për vlerësimin e riskut të korrupsionit. Është forcuar kuadri ligjor dhe institucional, me fokus në rritjen e efektivitetit të hetimeve administrative dhe mbështetjen e hetimeve penale dhe ndjekjes penale efektive, prokuroritë kanë shtuar numrin e databazave në përdorim dhe bashkëpunime me organet shtetërore dhe me homologë e vendeve partnere. Në fushën e ndërgjegjësimit, janë zgjeruar përpjekjet për edukimin mbi integritetin dhe etikën, si dhe për promovimin e një kulture të qëndrueshme integriteti, veçanërisht përmes brezit të ri. Raporti është përgatitur në përputhje me standardet e monitorimit nga Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit, sekretariat teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.



Raporti i monitorimit gjendet i publikuar në link: <https://antikorrupsioni.gov.al/kreu/lista-dokumenteve/raporte-monitorimi/>

Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit procedon 4 masa administrative dhe 11 rekomandime në sektorin publik

1-30.04.2026: Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në fushën e hetimit dhe verifikimit administrativ vijon me verifikimin e rasteve (ankesa/denoncime) të përcjella nga qytetarët dhe Koordinatorët Kundër Korrupsionit, kryesisht. Gjatë muajit prill 2026, janë administruar 3 raporte përfundimtare verifikimi për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri dhe Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Mbështetur në analizë të plotë të fakteve të marra, dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe në përputhje me natyrën e shkeljes së konstatuar, riskut e korrupsionit, ndikimin që ajo ka sjellë në mirëfunksionimin e institucionit, si dhe shkallën e përgjegjësisë individuale të punonjësve ndaj të cilëve pretendohet shkelja janë propozuar 4 masa administrative. Drejtorja ka proceduar propozimin për 11 rekomandime të cilat në 7 raste adresojnë çështje të natyrës administrative dhe lidhen me procedura konkrete të zbatimit, dhe në 4 raste të tjera adresojnë çështje me natyrë organizative referuar menaxhimit dhe procedurat e brendshme të institucionit.

Raportoni raste të korrupsionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në adresë: koordinatori.ak@dpak.gov.al

Shqipëria merr drejtimin e Iniciativës Rajonale Antikorrupsion

9.04.2026: Shqipëria merr drejtimin e përkohshëm të organizatës Iniciativa Rajonale Antikorrupsion (RAI). Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, Adea Pirdeni, mori stafetën për drejtimin e RAI për 6 muajt e ardhshëm, duke riafirmuar angazhimin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe avancimin e reformave antikorrupsion. Ky aktivitet konfirmoi rolin aktiv të Shqipërisë në promovimin e transparencës, integritetit dhe bashkëpunimit rajonal në rrugën drejt integritetit evropian. Në këtë kuadër, aktiviteti shërbeu edhe si një forum i nivelit të lartë për diskutime mbi Direktivën e re Antikorrupsion të Bashkimit Evropian. Forumi mbledhi drejtues të autoriteteve antikorrupsion të rajonit, përfaqësues dhe ekspertë të fushës, partnerë ndërkombëtarë për të diskutuar mbi përafrimin e veprimtarive publike me standardet e BE. Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit, Skerdi Tushi, panelist në këtë forum promovoi dhe ndau eksperiencat kombëtare antikorrupsion dhe theksuar përdorimin e mekanizmave parandalues të vendit, në veprim. Forumi theksoi rëndësinë e harmonizimit të mëtejshëm të kuadrit kombëtar me *aquis* të BE, si një hap themelor në procesin e integritetit evropian. Bashkëpunimi rajonal u vlerësua si një instrument thelbësor për adresimin e sfidave të përbashkëta dhe ngritjen e një qasjeje të koordinuar në luftën kundër korrupsionit. Shqipëria përfaqësohet në nivel teknik në RAI, nga **Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit**.

**Partneriteti me Austrinë forcon luftën kundër korrupsionit dhe garanton qeverisjen e mirë**

29.04.2026: Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh në fushën e shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit iu bashkua tryezës së rumbullakët, të organizuar me rastin e vizitës zyrtare në Tiranë të Ministres së Drejtësisë së Austrisë, Anna Sporrer. Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi shumë i mirë ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë, veçanërisht në drejtim të forcimit të mekanizmave parandalues të korrupsionit dhe konsolidimit të integritetit institucional. Një vlerësim i veçantë iu kushtua mbështetjes së ofruar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, e cila, në bashkëpunim me partnerë si PNUD, RAI dhe UNODC, ka kontribuar në zhvillimin e qasjeje të reja të bazuara në risk dhe në ngritjen e kapaciteteve institucionale për parandalimin e korrupsionit. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit ndau përvojën e fituar institucionale në zbatimin e metodologjive të vlerësimit të riskut të korrupsionit, duke theksuar kalimin nga qasjet e përgjithshme drejt një perspektive më të targetuar dhe të orientuar sipas sektorëve. Rezultat i drejtpërdrejtë i këtij bashkëpunimi është zhvillimi i instrumenteve të integritetit, kryerja e vlerësimit të riskut të korrupsionit dhe forcimi i kapaciteteve teknike në administratën publike. Në këtë kuadër, bashkëpunimi me partnerët austriakë mbetet një element kyç për avancimin e mëtejshëm të qasjeve parandalues dhe të bazuara në risk në luftën kundër korrupsionit. Ky bashkëpunim passjell ndërtimin e në administratë publike transparente, më të përgjegjshme dhe të orientuar drejt rezultateve.

Shqipëria prezanton progresin në fushën e antikorrupsionit në Forumin “Dialogu Strategjik Antikorrupsion”

21-22.04.2026: Në Vilnius, Lituani, u zhvilluan dy ditë intensive diskutimesh të nismave strategjike dhe shkëmbimi përvojash nga drejtues të autoriteteve antikorrupsion të Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore. Rrjeti i Agjencive Kundër Korrupsionit të OECD-së (ACN) organizoi këtë tryezë diskutimi dhe idesh, të



fokusuara mbi të ardhmen e reformave kundër korrupsionit në rajon (anëtare të ACN) dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional. Gjatë sesioneve dy-ditore, përfaqësuesit e kabientit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit, në nivel drejtues, prezantuan progresin e Shqipërisë në forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe modernizimin e qeverisjes publike, si pjesë e angazhimit të qëndrueshëm për përmbushjen e standardeve evropiane dhe avancimin e reformave në fushën e antikorrupsionit. Diskutimet u fokusuan gjithashtu në sfidat aktuale me të cilat përballen institucionet e fushës, si dhe në nevojën për qasje më inovative dhe të koordinuara në parandalimin dhe adresimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e administratës publike. Shkëmbimi i praktikave më të mira, eksperiencave konkrete dhe mësimëve të nxjerra nga vendet pjesëmarrëse u vlerësua si element thelbësor për ndërtimin e zgjidhjeve më efektive, rritjen e kapaciteteve institucionale dhe forcimin e besimit të qytetarëve në institucione. Në përfundim, u theksua rëndësia e vijmësisë së këtij bashkëpunimi ndërkombëtar si një instrument kyç në konsolidimin e reformave dhe avancimin e standardeve të qeverisjes së mirë.



Studentë të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës zhvillojnë një leksion të hapur për instrumentet e integritetit

17.04.2026: Në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit u zhvillua një orë e hapur leksioni me studentë të vitit të dytë të Fakultetit Juridik, në kuadër të lëndës “Etika dhe Integriteti në Administratën Publike”. Të shoqëruar nga pedagoge e lëndës, Prof. Dr. Eralda Methasani Cani, studentë të interesuar për hartimin e dokumenteve institucionale të Planeve të Integritetit, të njohur si instrumente kyç në parandalimin e korrupsionit në administratën publike, u njohën me këtë proces pune. Ora e hapur jashtë auditoreve të universitetit, u organizua në kuadër të praktikave institucionale që administrata publike i ofron studentëve. Në takimin (orën) e zhvilluar u dhanë informacione për kompetencat e drejtorisë nga Drejtori i Përgjithshëm, Skerdi Tushi, dhe drejtori i politikave antikorrupsion, Rovena Përgja. Stafi i drejtorisë shpjegoi hapat procedurale të vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e planeve të masave të integritetit për studentët. U prezantua në mënyrë të detajuar koncepti i integritetit, duke u ndalur në rolin thelbësor që ai luan në forcimin e transparencës, rritjen e llogaridhënies dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve publike, metodologjia e vlerësimit të riskut të integritetit, analizimi i risqeve të integritetit, si dhe fushat kryesore ku ato mund të shfaqen. U theksua rëndësia e hartimit të masave parandaluese në administratën publike, të cilat përbëjnë bazën e Planeve të Integritetit dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në standardet e qeverisjes së mirë. Aktiviteti morri formën e një diskutimi të hapur dhe interaktiv, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve përmes pyetjeve, komenteve dhe shkëmbimit të ideve. Kjo qasje kontribuoi në krijimin e një dialogu konstruktiv dhe në rritjen e interesit të studentëve për çështjet e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit.

Forcimi i kulturës së ligjshmërisë tek të rinjtë; orë e hapur informative në shkollën “28 Nëntori”, Shkodër

28.04.2026: Në kuadër të projektit “Edukimi kundër korrupsionit”, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit, shkoi në klasat e shkollës së mesme “28 Nëntori” në Shkodër për një orë e hapur mësimore me nxënësit e klasave të 10-ta. Tema “Kultura e ligjshmërisë dhe qytetaria e përgjegjshme”, mbledhi nxënës të shoqëruar nga mësues të lëndës “Qytetaria”, dhe promovoi rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e integritetit personal dhe shoqëror, si dhe rolin që secili individ luan në ndërtimin e një transparente. Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit u diskutua mbi rëndësinë e respektimit të rregullave, etikës dhe përgjegjësisë qytetare në jetën e përditshme, duke theksuar se edukimi dhe ndërgjegjësimi në moshë të hershme janë elementë thelbësorë në parandalimin e korrupsionit. Diskutimi përfshiu raste praktike dhe situata konkrete, të cilat nxitën pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe reflektimin mbi zgjedhjet e duhura morale dhe qytetare. Përmes një komunikimi të hapur dhe interaktiv, nxënësit u inkurajuan të shprehin mendimet e tyre, të diskutojnë sfidat që hasin në përditshmëri dhe të forcojnë rolin e tyre si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në komunitet.



Rritja e standardeve të integritetit në administratën publike përmes trajnimeve të dedikuara dhe zhvillimit të kapaciteteve

20-21.04.2026: Stafi tekniko-profesional i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, morri pjesë në trajnimin me temë “Vlerësimi i riskut të integritetit dhe hartimi i planit të Integritetit në institucionet publike”, i organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të projektit “GoEthics 2.0”. Gjatë trajnimit u trajtua kuadri konceptual i integritetit në sektorin publik, duke u ndalur në politikat dhe instrumentet kryesore që mbështesin forcimin e tij. Pjesëmarrësit u njohën gjithashtu me një mjet praktik për vlerësimin e riskut të integritetit, i cili u prezantua përmes demonstrimeve konkrete dhe diskutimeve interaktive. Në vijim, u theksua roli i aktorëve institucionalë në menaxhimin e integritetit, përfshirë koordinuesit e integritetit dhe strukturat drejtuese, si elementë kyç në zbatimin efektiv të politikave përkatëse. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe reflektimit mbi aplikueshmërinë e këtyre praktikave në kontekstin shqiptar. Trajnimi u përmbyll me nxjerrjen e konkluzioneve mbi rëndësinë e forcimit të integritetit institucional dhe nevojën për zbatimin në praktikë të Planeve të Integritetit, si instrumente thelbësore në parandalimin e korrupsionit.

Bashkitë dhe qarqet, institucione zbatuese të strategjisë antikorrupsion

3.04.2026: Në vijim të miratimit të Manualit për Zbatimin, Monitorimin dhe Raportimin e Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit, ofroi trajnimin e dedikuar për stafet teknike të njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkit) dhe qarqet. Trajnimi u fokusua në përdorimin praktik të Manualit, si një instrument pune i përditshëm për Pikat e Kontaktit Antikorrupsion, duke synuar standardizimin e proceseve të planifikimit, zbatimit, monitorimit, dhe raportimit të masave antikorrupsion në nivel vendor. Gjatë sesioneve u trajtuan kuadri strategjik antikorrupsion, rolet dhe përgjegjësitë institucionale, cikli i zbatimit të strategjisë dhe standardet e raportimit të bazuar në evidenca, të shoqëruara me ushtrime praktike mbi zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion. Një vëmendje e veçantë iu kushtua përmirësimit të cilësisë së raportimit institucional dhe forcimit të koordinimit ndërmjet institucioneve, si elementë kyç për një zbatim më të qëndrueshëm dhe të matshëm të strategjisë. Përmes këtij trajnimi, Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit vijon të mbështesë institucionet vendore në ndërtimin e kapaciteteve praktike për zbatimin e politikave antikorrupsion. Edhe ky aktivitet u mundësuar falë bashkëpunimit efektiv me ekspertizën teknike të projektit EU4GG të Delegacionit të Bashkimit Evropian



në Tiranë.